

VENDIM
Nr. 547, datë 13.6.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN PUBLIK”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në “Rregullat për prokurimin publik”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në kreun XI, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) “Në përputhje me rregullat e prokurimit publik, të përcaktuara në ligj dhe në këtë vendim, ministritë e linjës mund të nxjerrin rregullore apo udhëzime për hartimin e termave të referencës dhe të specifikimeve teknike për projekte në fushat specifike që ata mbulojnë, ndër të tjera, në shërbimet për teknologjinë e informacionit e të komunikimit, në ekonomi, në arsim, në shërbimet sociale e në shëndetësi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha